



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 05.05.2023
Kodi i ZRRE-së: V_1735_2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.10, Nenit 30 dhe Nenit 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, Nenin 4, Nenin 6, Nenin 7, Nenin 8 dhe Nenin 15 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura, të datës 09.03.2021 për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike, të bërë nga ndërmarrja SharrCem SH.P.K. adresa: Adem Jashari Nr.280, Hani i Elezit, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 05.05.2023 nxori këtë:

VENDIM

- I. I LËSHOHET LICENCA** për Furnizim me Energji Elektrike ndërmarrjes SharrCem SH.P.K. me numër Licence ZRRE/Li_88/23, për periudhën kohore prej 05.05.2023 deri 04.05.2028.
- II. Obligohet ndërmarrja** të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për SharrCem SH.P.K., të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 17.03.2023 ka pranuar nga ndërmarrja SharrCem SH.P.K. Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me energji elektrike në Kosovë.
- o Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit dhe kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të furnizimit me energji elektrike në Kosovë dhe legjislacionit tjetër në fuqi.



- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja **SharrCem SH.P.K.** me datë **07.04.2023** dhe **08.04.2023** ka njoftuar përmes gazetës (portaleve) palët e interesit se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës së sipërpërmendur, palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim të bërë nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- **SharrCem SH.P.K.** ka pasur licence për furnizim me energji elektrike të lëshuar nga Bordi i Rregullatorit për Energji, me numër licence ZRRE/Li_61/17, me periudhën pesë (5) vjecare, nga data 13.04.2018 deri me datë 12.04.2023.
- Licenca e lëshuar sipas këtij Vendimi do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence **jo më vonë se gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive të tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes **SharrCem SH.P.K.** dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.



Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes SharrCem SH.P.K. dhe
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:



Ymer Fejzullahu, kryesues



Lutfije Dervishi, anëtare



Gani Buçaj, anëtar